



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2020:034760

Datë: 11.10.2022

Numri i dokumentit: 03512472

C.nr.218/16

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me procesmbajtësen Azemine Berisha, në çështjen juridiko civile të paditësve Xh.L dhe M.L që të dy nga fshati Seqishtë, Komuna Hani i Elezit, të cilët me autorizim i përfaqëson Mimoza Kuka Bushi avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurës Agjencioni Pyjorë i Kosovës, Drejtoria Kordinuese Ferizaj të cilën me autorizim e përfaqëson D. Gj., për çështjen kontestuese vërtetim pronësie, në shumë prej 1.500,00 €, më datë 10.10.2022 në seancën gjyqësore pa praninë e palëve ndërgjyqëse, ndërsa më datën 11.10.2022 bëri përpilimin me shkrim të këtij:

**A K T V E N D I M**

I. Padia e paditësve Xh.L dhe M.L që të dy nga fshati ..., Komuna Hani i Elezit, e ushtruar më datën 15.12.2016, kundër të paditurës Agjencioni Pyjor i Kosovës – Drejtoria Kordinuese Ferizaj, për çështjen kontestuese vërtetim pronësie pranohet **SI E TËRHEQUR**.

II. Secila palë i përballon shpenzimet e krijuara.

**A r s y e t i m**

Paditësit përmes të autorizurës së tyre në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, më datën 15.12.2016, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Agjencioni Pyjor i

Kosovës – Drejtoria Rajonale Ferizaj. Me këtë padi ka kërkuar që të vërtetohet pronsia për ngastrat kadastrale ....., dhe ... të gjitha në zonën kadastrale ... si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata i ka caktuar disa seanca, ka nxjerr prova me ekspertizë gjeodezike dhe për datën 10.10.2022, e ka caktuar seancën kryesore në të cilën seancë nuk kanë prezentuar as e autorizuar e paditësve as e paditura, e autorizuar e paditësve para seancës e ka dorzuar pasrashesën me të cilën e njofton gjykatën se e bënë tërheqjen e padisë.

Gjykata pas analizimit të parashtresës së datës 10.10.2022, padinë e paditësve e pranoi të tërhequr, sepse kështu ka kërkuar pala paditëse. Me dispozitën e nenit 261.2 të LPK-së , është e paraparë se pala paditëse mundë ta tërheqë padinë deri në momentin e përfundimit të shqyrtimit kryesorë në qoftë se pala e paditur e jep pëlqimin për tërheqjen e padisë .Në rastin konkret pala e paditur e ka dhënë pëlqimin përmes telefonit.

Gjykata sa i përket shpenzimeve vendosi që social palë ti përballon shpenzimet e krijuara sepse me parashtresën për tërheqje padisë pala paditëse nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës të bëra deri në këtë fazë të procedurës.vendimin mbi shpenzimet e ka bazuar në neni 452.1 të LPK-së.

## GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.218/16 prej datës 10.10.2022

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

### **KËSHILLA JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi pala e pakenaqr ka të drejtë të paraqes ankesë në afatë prej 7 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.Ankesaparaqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatat.

*Expeduar me 11.10.2022*

*1 x 1 të autorizuarit të paditësve*

*1 x 1 të paditurës*

Numri i lëndës: 2020:034760  
Datë: 11.10.2022  
Numri i dokumentit: 03512472